



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2020:066688
Datë: 11.03.2024
Numri i dokumentit: 05433280

C.nr.796/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Shefqet Baleci, në çështjen juridike të paditësit B.M nga ..., të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij Rrahim Hajdari, avokat në Gllogoc, kundër të paditurës Komuna e Gllogocit, Drejtoria e Arsimit në Gllogoc, me objekt kontesti kompensim i shujtës ditore, vlera e kontestit 1,168 €, jashtë seance, me datën 11.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET SE ËSHTË TËRHEQUR** padia e paditësit B.M nga ... , kundër të paditurës Komuna e Gllogocit, Drejtoria e Arsimit në Gllogoc, lidhur me kompensim i shujtës ditore, vlera e kontestit 1,168€.

A r s y e t i m

Paditësi B.M nga ... përmes të autorizuarit të tij në këtë gjykatë ka parashtruar padi me datë 11.06.2020, kundër të paditurës Komuna e Gllogocit, Drejtoria e Arsimit në Gllogoc, lidhur me kompensimin e shujtës ditore, vlera e kontestit 1,168 €.

Paditësi me parashtrësën e datës 27.07.2022, përmes të autorizuarit të tij Av. Rrahim Hajdari, e ka tërhequr padinë e tij të paraqitur me datë 11.06.2020, kundër të paditurës Komuna e Gllogocit lidhur me kompensimin e shujtës ditore duke theksuar se paditësi kërkesën e tij e ka realizuar në procedurë administrative.

Gjykata duke u bazuar në nenin 387. par.1. pika c, lidhur me nenin 261 par.1,3,4 dhe 5 të LPK-së, ka marrë aktvendim me të cilin ka konstatuar se paditësi e ka tërhequr padinë ndaj të paditurës në këtë çështje juridike dhe ka vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, C.nr.796/20, me datë 11.03.2024

**Gjyqtari
Shefqet Baleci**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.